



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLES SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN
REGJISTRI I KËRKESAVE-ANKESAVE VITI 2023

Nr. Rendor (1)	Data e regjistrimit Kërkesës (2)	Objekti (3) (Përmban ede përmbledhje të kërkesës)	Data e kthimit të përgj. (4) (Përmban edhe përmbledhjetë përgjigjes)	Data e përgjigjes Kërkesës (5)	Statusi kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	10.01.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, gazetare B.R. 1. Me sa gjyqtare po punon Gjykata e Rrethit Elbasan? 2. Sa eshte numri i dosjeve te pashqyrtuara? 3. Si do veprohet per shqyrtimin e tyre?	Përgjigje 1. Në vijim të kërkesës tuaj, ju vemë në dijeni se nga të dhënat e statistikave rezulton se: 1. Gjykata e Rrethit GJyqësor Elbasan nga data 01/01/2023 gjykon me 6 gjyqta. 2. Nga të dhënat statistikore periodike për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, rezulton se për 9 mujorin e parë 2022 kanë qenë në gjykim (shqyrtim) 3130 çështje gjyqësore. 3. Në lidhje me shqyrtimin e tyre do të ndiqet e njëjta procedure e zbatimit të kodit të procedurave penale dhe civile.	10.01.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
2	11.01.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Prokuroria Përgjithshme. "Për garantimzin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",ka në proces verifikimi shtetasin E. M, me të dhënat e identitetit si më poshtë: E.M., F. M., Në zbatim të nenit 8. pika 5. nenit 9 të ligjit nr. 138/2015, kërkojmë të kryeni verifikime dhe të na vini në dispozicion kopje të njësuara me origjinalin të vendimit të mësipërm si dhe çdo vendim penal në emër të kësij shtetasi, përfshirë dhe vendimet për masat e sigurimit personal. K.B	Përgjigje 2. Në përgjigje të kërkesës me numër prot. 1270/43 ex22, mbërritur në rrugë postare date 11.01.2023 në adresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ju vemë në dijeni se nga kërkimi i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan: Për shtetasin E.M., nuk rezulton të ketë vendime penale dhe vendime për masat e sigurimit personal. Për shtetasin F.M., nuk rezulton të ketë vendime penale dhe vendime për masat e sigurimit personal.	19.01.2023	I plotë	Nuk ka tarifë

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E. S., gazetares Ora News dhe Egnatia News.

Ju lutem mund të më ndihmoni me një informacion në lidhje me numrin e dosjeve që janë aktualisht duke u shqyrtuar në gjykatën e Elbasanit!

Sa është numri i tyre?

Sa kanë mbetur stok?

Sa raste ka pasur vitin 2022 të dhunes neper familje?

Sa urdhëra mbrojtjeje janë dhënë për gratë gjatë vitit 2022?

Përgjigje 3.

Në përgjigje të kërkesës tuaj në adresën elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan më datë 31.01.2023, nga të dhënat statistikore të regjistruara nga zyra e statistikave në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezultojnë se për vitin 2022 janë regjistruar :

1. Çështje penale

- Të mbartura nga viti 2021, 321 çështje
- Të ardhura të reja 777 çështje

Total i çështjeve penale të regjistruara për vitin 2022 është 1098 çështje nga të cilat janë:

- përfunduar 714 çështje
- janë mbartur për vitin 2023, 384 çështje

Kërkesa penale për vitin 2022 në total janë regjistruar 2793 .

2. Çështje civile

- të mbartura nga viti 2021 ,1446 çështje
- Të ardhura të reja në vitin 2022 ,3349 çështje

Total i çështjeve gjyqësore civile për vitin 2022 është 4795,nga të cilat janë :

- përfunduar 3038 çështje
- janë mbartur për vitin 2023, 1757 çështje

Në zbatim të Nenit 130/a. Dhuna në familje, për vitin 2022 janë regjistruar 251 çështje ,28 prej të cilëve janë zbatuar ``**Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje**``.

Lidhja me familjarët në dhunën në familje shpërndahe si më poshtë :

- 187 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga bashkëshorti
- 12 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga vëllai
- 8 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga fëmija
- 17 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga prindi 27 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga të tjerë

Në zbatim të ligj Nr.9669, neni 10 dhe 13,për vitin 2022 janë pranuar 131 urdhëra mbrojtjeje, janë hedhur poshtë 64 dhe janë pushuar 56 .

4	10.02.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues C.S.	Përgjigje 4	13.01.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
		Jam nënshetase shqiptare me banin në Itali dhe jam e martuar në Shqipëri me një nënshetase shqiptar. Ju kërkoj ju lutem nese mund të më informoni për procedurën e divorcit, cila është rruga me e shpejtë dhe më ekonomike, nëse mund të bëj padi edhe pa qenë fizikisht në Shqipëri dhe kostot e procedurës.	Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadsisë me shkrim në gjuhën shqipe në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Proedurës Civile me objekt “Zgjidhje Martese”. Kërkesëpadia paraqitet në gjykatë nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij ligjor i cili duhet të jetë i pajisur me prokurë nga paditësi. Kërkesëpadia mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës. Me paraqitjen e kërkesëpadsisë paguhen tarifat, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, vlerat e së cilave iu komunikohen nga personeli që bën regjistrimin e kërkesëpadsisë. Tarifat gjyqësore i gjeni në lidhjen më poshtë: https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-rrethit-elbasan/gjykata/informacion/tarifa-gjyq%C3%ABsore/			
5	20.02.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues K.M.	Përgjigje 5	21.02.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
		Kam gjyqin në 1 mars ne Greqi për njohjen e procesit, po akoma nuk kam asnjë përgjigje? Si të veprojmë? Faleminderit	Nga verifikimi i kryer për çështjen me nr “” dhe nr akti “”” Gjyqtari i çështjes pas zbardhjes së vendimit, ka bërë dorëzimin e dosjes sipas procedurës në arkivën e Kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Procedurat e ndjekura për njoftimin e palëve gjatë një procesi gjyqësor janë të administruara në dosjen gjyqësore, të cilën mund ta kërkonit me nr “” në Kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dosja nuk mund të dërgohet në menyre elektronike nga Gjykata. Për tërheqjen e akteve të dosjes duhet të paraqiten fizikisht palët në proces ose përfaqësuesi i tyre ligjor i pajisur me prokurë përfaqësimit në Zyrën e Kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në çdo kohë, e cila ju mundëson pajisjen më aktet e dosjes pas kryerjes së procedurave administrative për pagesën e tarifave për shpenzimet e kopjeve të akteve të dosjes me vulë të njomë.			
6	21.02.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues BKT.	Përgjigje 6	22.02.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
		Kërkesë për zbardhjen e Vendimeve për lëshim Urdhëri Ekzekutimi në lidhje me debitorin N “” Shpk. BKT sha, në cilësinë e palës kreditore ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan Kërkesën Nr. “” Prot., datë 22. 11.2022 dhe Kërkesën Nr. “” Prot, datë 22. 11.2022 për lëshimin e Urdhërave të Ekzekutimit për debitorin N “” Shpk. Pas interesimeve të vazhdueshme pranë sporteleve të gjykatës, vendimet e sipërcituara ende nuk na janë vënë në dispozicion. Në cilësinë e palës së interesuar, kërkojmë të bëni verifikimet përkatëse për këto raste dhe të na mundësoni zbardhjen e Vendimeve për lëshimin Urdhërave të Ekzekutimit në lidhje me këtë debitor.	Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr prot. ..., ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar me aktin nr “” prot, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në lidhje me kërkesën ju informojmë se nga kërkimi i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (ICMIS), rezultoi se për palët në proces gjyqësor N “” SH.P.K dhe BKT janë dy çështje të regjistruara me të dhënat si më poshtë: 1-Nr çështjes 0007 “” Urdhër-Ekzekutimi 2-Nr çështjes 90007”” Urdhër-Ekzekutimi Ju informojmë se për shkak të ngarkesës çështjet janë me status në përpunim, vendimet e arsyetuara do t’iu dërgohen palëve sipas procedurës.			

7	15.02.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues KLGJ.	Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, ju bëjmë me dije se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është regjistruar me aktin nr. prot., datë 07.02.2023, ankesa në emër të z. L. H., i cili ngre pretendime në lidhje me shqyrtimin e çështjescivile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Sa më sipër, lutemi të informohet Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ankuesi lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e tij, nëse ankesa është adresuar në përputhje meparashikimet ligjore në fuqi. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni ankesën administruar pranë KLGJ-së me aktin nr. prot., datë 07.02.2023.	Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr ...prot, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar me aktin nr. prot, datë 16.02.2023, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në lidhje me ankesën e shtetasit z. L.H, nga kërkimi i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (1CMIS), ju informojmë se: 1. Nuk rezultojnë çështje të regjistruara për gjykim nga gjyqtari z. B. M. me palë në proces shtetasin z. L.H 2. Nuk rezultojnë çështje të regjistruara për gjykim nga gjyqtarja znj. I. M. me palë në proces shtetasin z. L. H. 3. Nuk rezultojnë çështje gjyqësore me palë në proces shtetasin z. A. H. Lutemi që z. L.H. të saktësojë të dhënat për palët në proces dhe vendimet për të cilat ngre pretendimet në ankesën e tij.	22.02.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
8	24.02.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues H.A.	Jam regjistruar në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, në fushën e ekspertizës Licencë vlerësues dëmsh në sigurime për dëme materiale, (motorike e të pronës) dhe dëme shëndetësore, për ta ushtruar në gjykata, përfshirë Gjykatën Tuaj. Bashkëlidhur vërtetimi nga Ministria e Drejtësisë /Regjistri Elektronik të Ekspertëve dhe kërkesa drejtuar Gjykates, të nënshkruara elektronikisht.	Regjistrimi i ekspertëve në çdo fushë gjëndet në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve të publikuar nga Ministria e Drejtësisë në lidhjen si më poshtë: https://www.drejtesia.gov.al/regjistri-elektronik-i-eksperteve/ Kjo lidhje është e afishuar edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në fund të faqes së lidhjes së mëposhtme gjëndet edhe lidhja që të adreson automatikisht në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve të regjistruar. https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-rrethit-elbasan/gjykata/avokatet-e-gjykates/	27.02.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
9	03.03.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Gazetare B.K Top Channel	Sipas ligjit 8116 (po ua nis bashkëngjitur bazën ligjore) si përfaqësues të mediave në Elbasan kërkojmë, lejimin e ndjekjes së seancave gjyqësore (pa prani të kamerave).Ju lutem te merret parasysh kërkesa jonë e cila është në zbatim të ligjit. Kërkojmë nga ana juaj ta përcillni këtë kërkesë tek drejtuesit e gjykatës.	Në përgjigje të kërkesës tuaj për ndjekjen e seancave gjyqësore, iu informoj se ndjekja e seancave gjyqësore për të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit është e rregulluar sipas urdhër Nr.6777/5, datë 30.9.2010 për miratimin e rregullores "Për Marrëdhënien e Gjykatës me Publikun" të cilën mund ta aksesoni në lidhjen si më poshtë të faqes zyrtare të Gjykatave: https://www.gjykata.gov.al/media/1545/rregullore-p%C3%ABr-marr%C3%ABdh%C3%ABnien-e-gjykat%C3%ABs-me-publikun.pdf Referohuni seksionit IV`` Marrëdhënia e gjykatës me median`` të këtij urdhëri, ku do të informoheni mbi procedurat që ndiqen nga Gjykata për ndjekjen e seancave gjyqësore nga media, urdhëri si më poshtë vijon: 1. Ndalimi i regjistrimit, transmetimit apo shpërndarjes së paautorizuar të seancave gjyqësore. 1.1. Seanca gjyqësore mund të jenë të regjistrueshme dhe të lejohen të transmetohen në media me kërkesë të medias ose me nismë të trupit gjykues. Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, i plotë ose i pjesshëm, bëhet vetëm kur nuk cenon rregullat e procesit të rregullt.	09.03.2023	I plotë	Nuk ka tarifë

1.2. Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë plotësisht ose pjesërisht sipas urdhrit të trupit gjykues, i cili gjykon çështjen objekt gjykimi.

1.3. Trupi gjykues ka të drejtë ekskluzive: a) që të lejojë ose ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës; b) që të lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesës së seancës; c) që të ndalojë transmetimin e pamjeve konkrete gjatë një seance, e cila është lejuar më parë të regjistrohet.

1.4. Regjistrimi audio-vizual në mjediset e sallës së gjyqit bëhet vetëm nga operatorët radiotelevizivë me lejen e trupit gjykues, nga punonjësit e sigurisë në gjykata ose nga vetë ZMP-ja. Çdo lloj regjistrimi tjetër është i ndaluar.

1.5. Kryetari i gjykatës, kur ka të dhëna se gjykimi i çështjes ka interes të madh për publikun, ose kur ka kërkesë nga media elektronike për transmetim të drejtpërdrejtë, e njofton trupin gjykues lidhur me këto çështje.

2. Të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve në gjykatë

2.1. Gazetarët lejohen të ndjekin pa asnjë pengesë seancat gjyqësore të hapura.

2.2. Përjashtimisht, mund të vendosen kufizime për rastet kur salla e zhvillimit të gjyqit është e pamjaftueshme për akomodimin e të gjithë të interesuarve për të ndjekur seancën. Në këtë rast, kryetari i gjykatës vendos administrativisht për pjesëmarrësit e lejuar në sallë sipas kësaj radhe preferenciale: fillimisht akomodohen pjesëmarrësit në gjykim (palët dhe avokatët); në vijim akomodohen familjarët dhe të afërmit; së fundi akomodohen gazetarët. Kur numri i familjarëve është më i madh sesa numri i vendeve në sallë, kryetari cakton një kuotë vendesh në sallë për familjarët, në mënyrë të tillë që të ruajë edhe një kuotë përfaqësuese për gazetarët. Në çdo rast, kryetari duhet të paralogarisë edhe hapësirën që duhet për vendosjen e mundshme të kamerave. Kamerat vendosen gjithmonë në fund të sallës dhe në mënyrë statike. Ndalohet përdorimi i tyre në mënyrë të lëvizshme.

2.3. Kur është mundësia teknike, regjistrimi dhe transmetimi bëhet nga vendi i posaçëm që administrohet nga ZMP-ja, gjithmonë sipas përcaktimeve konkrete që bën trupi gjykues. Në këtë rast, kryetari i gjykatës vendos për akomodimin e gazetarëve në vendin përkatës.

2.4. Gazetarët janë të detyruar të ndjekin procesin gjyqësor pa bërë asnjë koment dhe brenda rregullave që diktohen në seancë për zhvillimin e gjykimit të drejtë.

2.5. Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore për qëndrimin në ambientet e gjykatës, si dhe për qëndrimin në sallën e gjyqit vlejnë pa asnjë përjashtim për gazetarët dhe punonjësit e operatorëve radio- televizivë.

3. Procedura e ndjekjes së seancave gjyqësore nga ana e medias.

3.1. Çdo operator radio-televiziv (vendas dhe i huaj), që ka interes për të regjistruar dhe transmetuar plotësisht një seancë gjyqësore, duhet më parë të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë ZMP-së. Kërkesa mund të plotësohet edhe on-line kur ky shërbim ofrohet nga ZMP-ja e gjykatës përkatëse.

3.2. Kërkesa për pjesëmarrje duhet të paraqitet jo më vonë se 24 orë para orës së deklaruar për fillimin e seancës gjyqësore.

3.3. Kërkesa e regjistruar i paraqitet menjëherë nga ZMP-ja kryetarit të trupit gjykues dhe për dijeni kryetarit të gjykatës.

3.4. Kërkesa pranohet ose refuzohet plotësisht ose pjesërisht vetëm në çelje të seancës gjyqësore, kur të pranishëm në sallë janë edhe përfaqësuesit e medias që bën kërkesën. Kjo pjesë e seancës është e regjistrueshme dhe transmetohet pa asnjë kufizim.

10

17.03.2023

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues KIGJ

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, ju bëjmë me dije se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është regjistruar me aktin nr.prot., datë 01.03.2023, ankesa e përsëritur nga z. L. H., me anë të së cilës ka saktësuar të dhënat e palëve në proces. Me anë të kësaj shkrese, z. Hazizolli pretendon se nuk i është dhënë informacion lidhur me datën e zhvillimit të seancës gjyqësore me palë paditëse z. Ibrahim Rr.H dhe i paditur z. R. F.,
Sa më sipër, lutemi të informohet Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe z. Hazizolli lidhur me pretendimin e ngritur, nëse kërkesa është adresuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni shkresën administruar pranë KLGJ-sË me aktin nr.prot., datë 01.03.2023.

Përgjigje 10

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr prot, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar me aktin nr. 371 prot, datë 13.03.2023, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në lidhje me ankesën e përsëritur të shtetasit z. Lulzim Hazizolli, nga kërkimi i kryer në "Sistemin e Menaxhimit të Qështjeve Gjyqësore" në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (ICMIS), ju informojmë se shtetasit z.I brahim Hazizolli dhe z. Refat Frakulli janë palë në proces të çështjes civile themeli me numër, me nr akti.....
Çështja është marrë në shqyrtim nga gjyqtare I. M., në datë 31/03/2022 dhe është me status në përpunim për shkak të veprime procedurale.
Per këtë çështje rezulton të jetë planifikuar seancë më datë2023 ora 10:00.
Palët në proces do të njoftohen sipas procedurës së Gjykatës për planifikimin.

23.03.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

11

03.04.2023

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues G.S

Unë quhem G. S. Gjatë veprimtarisë si drejtues i shoqatës "D.S" më ka rezultuar se bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe transparenca e institucioneve publike vendimmarrëse dhe ligjzbatuese ka dhënë ndihmë të qenësishme për informimin e shoqërisë. Organizata jonë nëpërmjet një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, ofron ndihmë ligjore falas nëpërmjet paraligjorëve në disa qytete. Organizata "Drejtësi Sociale" ka në fokus kryesor ka advokimin, mbrojtjen, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, vecanërisht grupet (rome-egjiptiane, persona me aftësi të vecanta, studentët, të rinjtë, fëmijët, emigrantët, banorë/et e lokaliteteve periferike, etj).
Bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkojmë informacion mbi numrin e vendimeve të dhëna me masa dënimesh/pafajësi, nga ana e institucionit tuaj për veprën penale të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, për periudhën 2010-2022.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje nga ana juaj.

Përgjigje 11

Informacioni kërkuar gjendet në "Vjetarët Statistikor" të publikuar nga Ministria Drejtësisë.

Lidhja si më poshtë ju ndihmon të aksesoni në të dhënat e kërkuara:

<https://www.drejtësia.gov.al/statistika/>

Statistika - Ministria e Drejtësisë

Vjetari Statistikor 2004 Vjetari Statistikor 2005 Vjetari Statistikor 2006 Vjetari Statistikor 2007 Vjetari Statistikor 2008 Vjetari Statistikor 2009 Vjetari Statistikor ...

www.drejtësia.gov.al

03.04.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

12

12.04.2023

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues R. SH.

Kam nevojë për vërtetime nga gjykata dhe prokuroria për një aplikim. Dokumentet e kërkuara janë si më poshtë:
-Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
-Vërtetim nga gjykata që nuk është në gjykim penal;
Pyetja ime eshte se ku dhe kur mund ti marr keto dokumente.

Përgjigje 12

Në përgjigje të kërkesës tuaj ju informojmë se:

Vërtetim nga prokuroria për ndjekje penale;
Vërtetim nga gjykata për gjykim penal;

Duhet të paraqiteni në Institucionet përkatëse fizikisht për t'i tërhequr.
Pas plotësimit të formularit të apikimit dhe pagesës së tarifave gjyqësore, do të kryehet nga pesoneli administrates verifikimi i të dhënave dhe në bazë të të dhënave që do të gjenerohen do të pajiseni me vërtetimet e kërkuara.

12.04.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Av. Xh. P.

Lutem që të më dërgoni elektronikisht Rregulloren e brendshme të Gjykatës së Juridikisionit të Përgjithshëm Elbasan, Rregulloren për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Mediat dhe cilindo akt administrativ, që përcakton rregulla dhe udhëzime të brendshme për Gjykatën e Juridikisionit të Përgjithshëm Elbasan.

Përgjigje 13

Veprimtaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan bazohet në:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,

Ligj nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

Ligje e akte të tjera juridike, në fuqi, që normojnë veprimtarinë e Gjykatës, Gjyqtarëve, administratës së Gjykatave, shërbimeve gjyqësore, menaxhimit dhe çështjeve gjyqësore dhe marrëdhënien e Gjykatës me degët e tjera të pushtetit shtetëror, publikun dhe median.

Zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median e bazon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligj Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

Urdhër Nr.6777/5, datë 30.9.2010 për miratimin e rregullores “Për Marrëdhënien e Gjykatës me Publikun”,

Ligj Nr. 97/2013 “për mediat audiovizive në republikën e shqipërisë” Ligj Nr.9887, datë 10.3.2008 “për mbrojtjen e të dhënave personale”

Ligj Nr. 8457, datë 11.02.1999 “për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror” (Ndryshuar me ligjin nr.9541, datë 22.5.2006) (Ndryshuar me ligjin 25/2012).

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.L.

Kërkojmë nga ana juaj të na informoni si më poshtë vijon:

Së pari, cili është numri i çështjeve penale të gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprat penale të parashikuara nga Neni 100, Neni 101, Neni 107/a, Neni 108, Neni 108/a, Neni 117, Neni 121/a/3 të Kodit Penal, për periudhën Janar 2020 - Mars 2023. Lutemi të na i specifikoni rastet për secilin vit.

Së dyti, në vijim të pyetjes së parë, kërkojmë kopje të anonimizuar të vendimeve gjyqësore për veprat e mësipërme, përgjatë periudhës Janar 2020 - Mars 2023. Informacioni i kërkuar mund të na vihet në dispozicion edhe në adresën elektronike.

Përgjigje 14

Në vijim të kërkesës tuaj, ju informojmë se nga kërkimi ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështje Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën Janar 2020- Prill 2023 rezultojnë të gjykuara këto çështje nga nenet e cituara në kërkesën tuaj: Nr çështjes 5***-***05-13-2019, Baza Ligjore Neni 108/2,100/1 K.P. Data e vendimit 17.07.2020.

- Nr çështjes 5***3-0***6-13-2020, Baza Ligjore Neni 100/1 K.P. Data e vendimit 01.04.2020.
- Nr çështjes 7***4-0***1-13-2019, Baza Ligjore Neni 108/A/1 DHE 321/1 K.P. Data e vendimit 17/02/2020.
- Nr çështjes 7***4-0***4-13-2020, Baza Ligjore Neni 108/A/1 K.P. Data e vendimit 24/02/2021.
- Nr çështjes 5***0-0***2-13-2020, Baza Ligjore Neni 108/1 K.P. Data e vendimit 21/04/2020.
- Nr çështjes 5***2-0***7-13-2020, Baza Ligjore Neni 121/A/3 K.P. Data e vendimit 29/07/2020.
- Nr çështjes 7***3-0***5-13-2020, Baza Ligjore Neni 121/A /1 Data e vendimit 03/02/2021.
- Nr çështjes 5***3-0***7-13-2020, Baza Ligjore Neni 110/1 E 121/A/2 K.P. Data e vendimit 31/01/2022.
- Nr çështjes 7***3-0***8-13-2020, Baza Ligjore Neni 121/A/2 K.P. Data e vendimit 14/07/2020.
- Nr çështjes 7***3-0***9-13-2020, Baza Ligjore Neni 121/A/1 K.P. Data e vendimit 25/02/2020.

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Av. R. Z.

A. Ju shkruaj në lidhje me mundësinë e pajisjes me një formular aplikimi për depozitim në një kërkesë padie pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Paraqitja e kërkesë padisë do të kryhet nëpërmjet shërbimit postar nga unë në cilësinë e përfaqësueses ligjore të palës.

B. Faleminderit për informacionin,

Për paditë e zgjidhjes së martesës me tarife 3000 lek te reja, aplikohet e njëjta procedurë? Pra po me Bankë?

- Nr çështjes 5***5-0***0-13-2021, Baza Ligjore Neni 121/A/1 K.P. Data e vendimit 17/03/2021.
- Bashkëlidhur gjenden kopje të vendimve të anonimizuara.

Përgjigje 15

A.Në vijim të kërkesës tuaj, ju informojmë mbi procedurën e paraqitjes së kërkesë padisë nëpërmjet postës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të cilën mund të ndiqni këto hapa:

1- Klikoni në lidhjen si më poshtë vijon :

<https://www.gjykata.gov.al/.../gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/>

2- Klikoni butonin poshtë informacionit si më poshtë vijon:

Tarifë gjyqësore për kërkesë padi standarte ose 1% mbi vlerën e saj.

4. Pasi të shkarkoni faturën e mandat-pagesës, në të cilën gjenden të përcaktuara:

- kodi institucionit
- kodi i degës së thesarit ku vepron
- kodi i llogarisë ekonomike i cili plotësohet automatikisht pasi të keni vendosur në kuadratët e përcaktuar:
- vlerat e shumës për të cilën do të paguhet tarifa
- numrin e palëve në kërkesë padi

Pas plotësimit të vlerave do t'ju gjenerohen automatikisht vlerat e faturave që duhet të paguani në çdo bankë të nivelit të dytë, në kodin e llogarisë bankare të institucionit i cili gjëndet i afishuar në mandat-pagesë.

Pasi të keni plotësuar mandat-pagesën dhe të keni përfunduar pagesën në çdo bankë të nivelit të dytë, një kopje e mandat-pagesës vendoset bashkëlidhur me kërkesë padinë dhe dërgohet nëpërmjet postës në adresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

B. Cdo pagesë tjetër që nuk përmendet dhe nuk ka zë në kodin e llogarisë ekonomike në mandat-pagesë duhet dorëzuar fizikisht në zyrën e kryesekretarisë, ku arka ju pajis me mandatin e pagesës në momentin e dorëzimit të kërkesëpadisë.

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.B.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 110/ 2016 "Për Falimentimin" neni 12 pika 1,4, neni 203 pika d dhe VKM Nr. 542 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit" të na dërgoni:

- 1- Numrin e kërkesave për hapjen e procedurave së falimentimit gjatë 3 muajorit të I-rë të vitit 2023;
- 2- Bashkëlidhur të dërgoni kopje të këtyre vendimeve gjyqësore; Elbasan
- 3- Dërgimin periodik statistikor të këtyre të dhënave çdo 3 muaj;
- 4- Përmbushjen e detyrimit ligjor për njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit nga ana e sekretarisë gjyqësore për çdo kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes.

A. B.

Përgjigje 16

Në përgjigje të kërkesës suaj nr... prot, dt 16.05,023, në lidhje me kërkesat për procedurat e falimentimit, ju bëjmë me dije se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk ka ceshtje te regjistruar apo gjykyar për 3 mujorin e parë të 2023.

KANCELARI

17	24.05.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues K.T.	Përgjigje 17	24.05.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
		Ka mundësi të pajisem me certifikatën online në faqen e gjykatës duke vënë të dhënat e çështjes apo duhet të paraqitem në sportelet e shërbimit të publikut?	Vendimet gjyqësore i komunikohen palëve sipas procedurës, nëse ju duhet kopje e vendimit për dokument duhet të paraqiteni në sportelet e Gjykatës për t'i tërhequr fizikisht me vulë të njomë pas pagesës së tarifave gjyqësore!			
18	02.06.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.GJ.	Përgjigje 18	02.06.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
		Une jam B.Gj., jurist prane Byrose Shqiptare te Sigurimeve. Po ju dergoj këtë e-mail me qëllim marrjen e një informacioni mbi procedurat e ngritjes së padisë së regresit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.	Bashkëlidhur gjendet formati i mandat-pagesës për tarifat gjyqësore. Pasi ta keni plotësuar mandat-pagesën, sipas të dhënave të afishuara në mandat-pagesë, ku është përcaktuar kodi institucionit, kodi i degës së thesarit ku vepron dhe kodi i llogarisë ekonomike paraqituni në një nga bankat e nivelit të dytë për të kryer pagesën . Mënyra e plotësimit të mandat-pagesës behët automatikisht pasi të keni vendosur në kuadratët e përcaktuar vlerat të tarifave të shumës për të cilën do të paguhet tarifa dhe numrin e palëve në kërkesë padi, pas plotësimit të këtyre vlerave ju gjenerohen automatikisht vlerat e faturave që duhet të paguani në bankë sipas kodit të llogarisë bankare. Pasi të keni kryer pagesat, një kopje e mandatit vendoset bashkëlidhur me kërkesë padinë e cila do të dërgohet nëpërmjet postës në addressë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.			
		Cfarë hapash duhet të ndjek dhe si duhet paguar taksa 1% e padisë që dua të depozitoj në këtë Gjykatë?	Formularin e taksës 1% e gjeni në faqen zyrtare të Gjykatës në lidhjen si më poshtë: https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-rrethit-elbasan/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/ Informacion mbi plotësimin e gjeni gjithashtu të publikuar në rrjetin social të Gjykatës në lidhjen si më poshtë: https://www.facebook.com/photo/?fbid=3364722073772070&set=a.2053663408211283 Në lidhje me hapat për padinë e regresit ju lutem referohuni kodeve të procedurave.			
19	02.06.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues R.Gj., Gazetar i Report Tv.	Përgjigje 19	05.06.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
		Po zhvilloj një kronikë në lidhje me mungesën e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve që janë aktual në Gjykatën e Rrethit Elbasan dhe për mungesën e tyre.	Sipas të dhënave statistikore të referuara nga zyra e Kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për 3 mujorin e parë të vitit 2023 rezultojnë 4401 çështje për gjykim. Nga të dhënat e gjeneruara nga kërkimi ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezultojnë të regjistruara 3533 çështje të reja të ardhura nga data 01.01.2023 deri më 05.06.2023. Në të dhënat e mësipërme duhet konsideruar fakti që numri i çështjeve është dinamik. Koha e pritjes së qytetarëve për çështjet e tyre është në varësi të natyrës së çështjes dhe ngarkesës së listave të gjykimit të Gjyqtarëve.			
		Sa është numri i Gjyqtarëve? Këto që janë a i mbulojnë dot të gjitha çështjet? Dhe si do të veprohet në vazhdim.				

20	13.06.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues gazetare I.SH Euronews Albania Doja të dija numrin e të miturve që janë përfshirë në çështje penale gjatë vitit 2022 dhe nqs ka ndonjë të dhënë të 2023 që të mundem të bëj një krahasim për kronikën.	Përgjigje 20 Në vijim të kërkesës tuaj, iu informojmë se në bazë të statistikave të komunikuara dhe publikuara nga zyra e statistikave në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton se të dënuar të mitur gjithsej për vitin 2022 janë 13 (trembëdhjetë) të mitur, nga ku 1 (një) prej tyre është i mitur femër. Masa e dënimit për 6 (gjashtë) prej të miturve të dënuar, është aplikuar masa e dënimit deri në dy vjet, për 6 (gjashtë) të mitur të tjerë është aplikuar masa e dënimit neni 59/a, dhe për 1 (një) prej tyre neni 63. Baza ligjore për 6(gjashtë) prej të miturve të dënuar është shkelje e nenit 291, 1 (një) prej të miturve të dënuar rezultojnë me shkelje të nenit 134, 2 (dy) prej të miturve të dënuar rezultojnë me shkelje të nenit 130/a/2/3/4 dhe 4(katër) prej të miturve të dënuar rezultojnë me shkelje të nenit 117/2,3. Për vitin 2023 të dhënat statistikore publikohen në fillim të vitit pasardhës.	13.06.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
21	03.07.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Agjencia Kombëtare e Falimentimit Në mbështetje të Ligjit nr.110/ 2016 “Për Falimentimin”, neni 12 pika 1 dhe 4 ,neni 203 pika d dhe VKM nr 542 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit” pika 4/ç , ju lutem të na dërgoni: 1- Vendimet gjyqësore të skanuara me objekt “Kërkesë për hapje te procedurave te falimentimit” për periudhën PRRILL – QERSHOR 2023; 2- Plotesimi I tabelës bashkëlidhur ; 3- Dergimin në vazhdimësi të cdo kërkesë per fillimin e procedurës së falimentimit jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas detyrimit ligjor nga ana e sekretaris gjyqësore parashikuar ne ligjin 110/2016	Përgjigje 21 Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se nga kërkimi ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe komunikimi me sekretaret regjistruese, nuk rezultojnë regjistrime me objekt “KËRKESË PËR HAPIJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT” referuar bazës ligjore të Ligj Nr.8901, Datë 23/05/2002 "PËR FALIMENTIMIN" (I Ndryshuar), për periudhën PRILL – QERSHOR 2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për kërkesën tuaj janë vënë në dijeni sekreatet regjistruese të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Lutemi të dërgoni të dhënat e kontaktit për raportimet në vijimësi të kërkesave të regjistruara, në zbatim të afatit 5 ditor të parashikuar në Ligj 110/2016 “PËR FALIMENTIMIN”.	04.07.2023	I plotë	Nuk ka tarifë
22	07.07.2023	Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Zyra Përmbauesve B.S.A Pranë Zyrës Përmbaimore Private "B.S.A" sh.p.k, me kërkesë të pales kreditore OTP Bank sh.a. është vënë në ekzekutim titulli ekzekutiv Kontratë për Kartë Kredie A.E.G datë 11.11.2008. Per këtë titull ekzekutiv nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Eshtë lëshuar Urdhër Ekzekutimi Nr. regi. them. Date 11.11.2021 me palë: I.K. Kthim shume BSA	Përgjigje 22 Në përgjigje të kërkesës tuaj me Nr. Prot, ju njoftojmë se shkresa është administruar me Nr. Prot më datë 07.07.2023 në Zyrën e Protokollit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Ju informojmë se për publikimin e shpalljeve të Përmbauesve Gjyqësorë të cilat dorëzohen në rrugë postare dhe protokollohen nga Zyra e Protokollit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pas protokollimit ato publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	18.07.2023	I plotë	Nuk ka tarifë

Konstatohet, se nga momenti i depozitimit të shkresës sonë e deri më tani, nga ana juaj nuk na është komunikuar asnjë përgjigje lidhur me shpalljen e njoftimit Lajmërim për ekzekutim vullnetar ndonëse ka përfunduar çdo afat ligjor. Ndodhur në këto kushte, për efekt të vijimit të procedurave përmbarimore kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse nga ana e institucionit tuaj është kryer shpallja e njoftimit "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" nr... prot., nr. 4167 regj. datë 01.02.2023. Për veprimin apo mosveprimin tuaj duhet të na informoni zyrtarisht brenda afatit ligjor.

Zyra Përmbarimore Private "B.S.A" sh.p.k.

ditën e marrjes së postës ose një ditë më pas, në varësi të orarit të shpërndarjes së postës nga Zyra Protokollit. Pas dorëzimit ato publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rubrikën "Njoftime të tjera" me titullin "Lajmërim Përmes afishimit"

duke përcaktuar Zyrën e Përmbarimit dhe Përmbaruesin Gjyqësor si edhe Nr Prot., të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Njoftimi me shpallje për të cilin shprehni interes mban Nr...Prot, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Nr....Prot., të Zyrës së Përmbarimit "B.S.A", e cila është dorëzuar në rrugë postare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 04.04.2023, në Zyrën e Protokollit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe më date 05.04.2023, në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median e cila ka publikuar më datë 05.04.2023.

Gjykata nuk ndjek një procedurë për njoftim e Zyrës Përmbarimit për publikimin e shpalljes, pasi që pasi protokollohen në Zyrën e Protokollit delegohen për Publikim direkt në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median dhe publikohen të përditësuara. Konfirmojmë publikimin e shpalljes së Zyrës së Përmbarimit "B.S.A" me Nr., Prot., më datë 05.04.2023, e dorëzuar në rrugë postare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 04.04.2023. Kthimi i përgjigjes është procesuar edhe nëpërmjet postës elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Bashkëlidhur përgjigjes gjendet:

Kopje e printscrën e publikimit të shkresës me Nr. ... Prot., në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Kopje e shkresës me Nr..... Prot e Zyrës së Përmbarimit "B.S.A"

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Avokati i Popullit.

Kerkesë per informacion lidhur me personat ndaj të cilëve gjykatat kanë dhënë masën mjekësore "Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor"

Përgjigje 23

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. prot.dt. 10.07.2023, në lidhje me çështjet e gjykuara me objekt: "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" ju dërgojmë bashkëlidhur 9 vendime gjyqësore për vitin 2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Kancelari

31.07.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues KLGJ

Informim i ankuesit E.G në lidhje me përpeshëptim të çështjes sip alë në proces gjyqësor pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Përgjigje 24

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. prot., ju bëjmë m "" e dije se kërkesa juaj është regjistruar me aktin nr. .. prot, datë 26.07.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në lidhje me ankesën e shtetasit z. E.G, nga kontrolli i kryer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (ICMIS), ju informojmë se z. E.G., rezulton palë në proces të çështjes civile themeli me numër, me nr. akti dorëzuar më datë 13.10.2022.

Nga rezultatet e kontrollit në sistem, çështja rezulton të jetë me status në përpunim. Një kopje e kërkesës, u dorëzua nga zyra e protokollit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për dijeni të sekretares gjyqësore të çështjes së z. E. G. me numër

03.08.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues KRIIK

Kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Kërkesa për informim. Vendimi nr 38 datë 08.02.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka si mission mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut, si dhe të dimensionit të plotë të sigurisë njerëzore nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeverisjes demokratike, nxitjes së aktivizmit e të angazhimit qytetar si dhe nxitjes për përgjegjshmëri, transparence e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike.

KRIK në bashkëpunim me apo në kuadër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), si një ndër organizatat themeluese dhe drejtuese të KW, ka ndjekur në vazhdimësi, veçanërisht pas Reformës Zgjedhore të korrikut 2012, zhvillimin e të gjitha proceseve dhe veprimtarive politike

dhe institucionale, të cilat afektojnë drejtëpërsëdrejt apo indirekt integritetin e proceseve zgjedhore. Gjithashtu, KRIIK ka monitoruar në mënyrë të pjesshme apo të plotë të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara në vend që prej Referendumit për miratimin e Kushtetutës së Republikës me 1998 e deri më sot. Në vazhdim të këtij angazhimi, KRIIK, akredituar prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 38 datë 08.02.2023, po monitoron dhe ndjek me vëmendje situatën në vend si dhe zhvillimet politike e institucionale, përpara, gjatë dhe pas ditës së Zgjedhjeve të 14 Majit 2023, si dhe zgjedhjeve të përsëritura për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023., KRIIK Ju paraget Kërkesën për të patur informacionin mëposhtëm:

Sa është numri i kërkesave të depozituara në Gjykatën tuaj, nga shtetas shqiptarë që kanë kërkuar korrigjim të përbërësve zgjedhorë për shkak të mospërfshirjes apo vendosjes në qendrën e votimit të gabuar, pas publikimit të Listës Perfundimtare të Zgjedhësve; për zgjedhjet e përsëritura për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë të datës 23 korrik 2023?

Sa është numri i kërkesave të depozituara në Gjykatën tuaj, nga shtetas shqiptarë që nuk janë fare të regjistruar në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore, ku kanë vendbanim, për zgjedhjet e përsëritura për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë të datës 23 korrik 2023?

Lutemi kopje të vendimit të Gjykatës për secilën nga këto kërkesa duke respektuar dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa është numri i kërkesave të depozituara në Gjykatën tuaj, nga shtetas shqiptarë të cilët kanë kërkuar të ushtrojnë të drejtën për të votuar në IEVP-të përkatëse? Në cilat data janë paraqitur këto kërkesa në Gjykatë?

A ka proceduar gjykata me vendimarrje për çdo kërkesë të paraqitur?

Lutemi kopje të vendimit të Gjykatës për secilën nga këto kërkesa duke respektuar dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Informacioni i kërkuar mund të vihet në dispozicion edhe nëpërmjet postës elektronike.

Përgjigje 25

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. prot....., dt.25.08.2023 në lidhje me kërkesat dhe vendimet gjyqësore për regjistrime dhe korrigjime të adresës së qendrës së votimit etj. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju bëjmë me dije se:

2.Nuk ka vendimne gjyqësore eventuale.

1.Nuk ka kërkesa të depozituara për korrigjim të përbërësve zgjedhorë për zgjedhjet e përsëritura në Bashkinë Rrogozhinë.

3. Nuk ka kërkesa të depozituara për regjistrim për zgjedhjet e përsëritura në Bashkinë Rrogozhinë.

Për pikat 4,5,6 dhe 7 ju kemi kthyer përgjigje me shkresën tonë Nr. Prot

dt.12.06.2023 (bashkëlidhur) duke ju derguar 33 kopje vendimesh si citohet me lart. KANCELARI

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.L

Së pari, sa është numri i kërkesave për vlerësimin e trajnimit të pavullnetshëm të personave me sëmundje të shëndetit mendor, të regjistruara pranë institucionit tuaj nga Spitali Psikiatrik Elbasan gjatë periudhës janar 2013- gusht 2023? Ju lutem krahas totalit na specifikoni numrin për secalin vit.

Së dyti në vijim të pyetjes së parë, sa prej këtyre kërkesave janë pranuar dhe sa janë refuzuar.

Ju lutem, krahas totalit, na specifikoni numrin për secalin vit.

Përgjigje 26

I nderuar Z. E.L, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar me aktin nr.prot., datë 04.09.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në lidhje me kërkesën tuaj me bazë ligjore Ligj Nr. 44/2012 “PËR SHËNDETIN MENDOR”, me objekt “Numri i kërkesave për vlerësimin e trajtimit të pavullnetshëm të personave me sëmundje të shëndetit mendor”, të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për periudhën 2017-2023, nga rezultatet e kërkimit në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në regjistrin e kategorisë së kërkesave civile të vecanta rezultojnë të dhënat të cilat u përpunuan si në tabelën më poshtë për periudhën e kërkuar:

	Kërkesa civile të veçanta për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave meçrregullime të shëndetit mendor			Revokimi i vendimeve për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor		
	Totali i kërkesa të regjistr uara për cdo vit	Të pranuar	Të pushuara	Totali i kërkesa ve të regjistr uara për revoki m	Të pranuar	Të rrëzuara
2017	0	0	0	0	0	0
2018	2	2	0	1	1	0
2019	6	5	1	5	4	1
2020	4	2	2	3	3	0
2021	0	0	0	0	0	0
2022	1	1	0	1	1	0
2023	0	0	0	0	0	0
TOT ALI	12	9	4	11	10	1

Në vitin 2017, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor”

Në vitin 2017, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të vecanta me bazë ligjore Ligj nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor”.

Në vitin 2018, janë regjistruar 2 (dy) kërkesa me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për

Shëndetin Mendor” me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullimetë shëndetit mendor” janë pranuar 2 (dy).

Në vitin 2018, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012“Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor” e cila është pranuar.

Në vitin 2019, janë regjistruar 6 (gjashtë) kërkesa civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm tëpersonave me çrregullime të shëndetit mendor”, janë pranuar 5 (pesë) dhe është pushuar 1 (një).

Në vitin 2019, janë regjistruar 5 (pesë) kërkesa civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetitmendor” janë pranuar 4 (katër) dhe është rrëzuar 1 (një).

Në vitin 2020, janë regjistruar 4 (katër) kërkesa civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm tëpersonave me çrregullime të shëndetit mendor”, janë pranuar 2 (dy) dhe janë pushuar 2.

Në vitin 2020, janë regjistruar 3 (tre) me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”,me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor”, janë pranuar 3(tre) .

Në vitin 2021, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm tëpersonave me çrregullime të shëndetit mendor”

Në vitin 2021, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të vecanta me bazë ligjore Ligj nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetitmendor”.

Në vitin 2022, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012“Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor” e cila është pranuar.

Në vitin 2022, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012“Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor” e cila është pranuar.

Në vitin 2023, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm tëpersonave me çrregullime të shëndetit mendor”

Në vitin 2023, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të vecanta me bazë ligjore Ligj nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, me objekt kërkesë “Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor”.

27

07.09.2023

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkuar Agjencia Kombëtare e Falimentimit

Në mbështetje të Ligjit nr.110/ 2016 “Për Falimentimin”, neni 12 pika 1 dhe 4 ,neni 203 pika d dhe VKM nr 542 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit” pika 4/ç , ju lutem të na dërgoni: Vendimet gjyqësore të skanuara me objekt **“Kërkesë për hapje të procedurave të falimentimit”** për periudhën **QERSHOR - SHTATOR 2023**; Plotësimi I tabelës bashkëlidhur; Dërgimin në vazhdimësi të cdo kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit jo më vonë se 5 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas detyrimit ligjor nga ana e sekretaris gjyqësore parashikuar në ligjin 110/2016.

Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se nga kërkimi ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe komunikimi me sekretaret regjistuese, nuk rezultojnë regjistrime me objekt **“KËRKESË PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT”** referuar bazës ligjore të Ligj Nr.8901, Datë 23/05/2002 "PËR FALIMENTIMIN" (I Ndryshuar), për periudhën **QERSHOR-SHTATOR 2023**, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

07.09.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

28

02.10.2023

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkuar K.P.

Jam K.P. Jam trashëgimtar i M.M.P., lindur në Elbasan. Kërkoj të më vihen në dispozicion të gjitha vendimet gjyqësore në Gjykatën e Elbasanit, që kanë ardhur si rezultat i shqyrtimit dhe kthimit të disa pronave të gjyshit tim. Kjo pasi disa dosje nuk i gjejmë në AKP. Ju lutem më ndihmoni si t'i aksesoj këto vendime.

Përgjigje 28

Në vijim të komunikimeve tona në lidhje me kërkesën tuaj dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, u krye verifikimi i indekseve manual për vitet 1992-2020 në Arkivën e Gjykatës. Nga kontrolli ushtruar rezultoi një vendim me paditës palët sipas prokurave të dërguara në postën elektronike të Gjykatës për palët G.P., S.P., E.P., me përfaqësues ligjor H.K., sipas objektit të kërkesës së datës 02.10.2023, për shqyrtim dhe kthim të pronave si trashëgimtarë të M.P.

Vendimi gjendet i skanuar bashkëlidhur kësaj shkrese.

Për këtë kërkesë ka patur korrespondencë të vazhdueshme Brenda kësaj periudhe për kthim përgjigje për të identifikuar më qartë palët dhe vendimet e kërkuara.

13.10.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

29

13.11.2023

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkuar Dhoma Kombëtare Përbaruesve Gjyqësorë Privatë.

Dhoma Kombëtare Përbaruesve Gjyqësorë Privatë në vijimësi është duke ndjekur çdo rast dhe denoncim që lidhet me pretendime të cenimit të të drejtave të qytetarëve nga shërbimipërbarimor gjyqësor privat dhe sa herë ka konstatuar shkelje, ka marrë masat përkatëse në mbrojtje të interesit publik dhe shërbimit përbarimor, i cili duhet të ushtrojë funksionin në respektim të plotë të të drejtave të qytetarëve.

Në përgjigje të kërkesës tuaj me Nr..... Prot., të regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me Nr... Prot., datë 13.11.2023, nga verifikimi i kryer I akteve bashkëlidhur kësaj kërkesë konstatohet se këto "Shpallje Ankandi" nga Zyra Përbarimit Privat T.G, nuk i përkasin kërkesave për afishim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

23.11.2023

I plotë

Nuk ka tarifë

Përgjatë muajve të fundit kemi administruar një sasi të madhe denoncimesh dhe ankesa qytetarësh, që lidhen me veprimtarinë e paligjshme të të njëjtit rreth subjektsh, tashmë të njohur publikisht dhe të kallëzuar penalisht nga ministri i Drejtësisë: "M.C.A", "F", "ADCA".

Këto tre subjekte tregtare, në bashkëpunim me disa përmbaues gjyqësorë privatë, që u është hequr licenca nga ministri i Drejtësisë përgjatë viteve, 2017-2018 dhe 2022-2023

janë angazhuar në favor të implementimit të një skeme të mirëfilltë të mashtrimit me pasoja direkte për mijëra qytetarë e që dyshohet se kanë çuar në një nivel masiv publik fenomenin e kallëzuar nga ministri i Drejtësisë, në shkurt 2020 - atë të "Shtrëngimit të debitorëve nëpërmjet procesit përmbaues për marrjen e kredive të reja" në përfitim të institucioneve financiare jobanka, "M.C.A", "F" dhe subjektit tregtar "ADCA".

Jemi informuar nga ankesat e shumta të qytetarëve dhe kemi konstatuar se gjendemi para një fenomeni të shumë përhapur në gjithë territorin, përgjatë gjithë vitit 2023. Një numër tepër i lartë dhe i pazakontë shkresash, janë adresuar për në gjykatat e vendit, për afishimin "Shpalljeve të ankandit" për shitje të pronave të llojeve të ndryshme, pasuri të paluajtshme, për shkak të proceseve përmbauese. Janë evidentuar me dhjetëra-qindra të tilla të afishuara në stendat reklamuese në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Sarandë, Gjirokastrë, Korçë etj.

Nga rastet e evidentuara, e përbashkëta e të gjitha akteve/afishimeve të ankandeve është konstatuar se ato janë dërguar në zyrat e administratës së gjykatave:

- nga i njëjti burim adresor, adresë në emër të "ADCA";
- mbajnë në zarfet postare të njëjtën logo, atë të ADCA";
- kanë kredencialet (vulë, nënshkrim) të të njëjtit përmbaues gjyqësor privat;
- tregojnë si kreditor vetëm dy subjekte: "M.C.A" dhe "F";
- të dy subjektet kreditore, përfaqësohen në çdo rast nga i njëjti subjekt tregtar - "ADCA" sh.p.k., që nuk është subject përmbaues apo zyrë përmbaues.

Të gjitha këto shpallje janë përcjellë për afishim pranë gjykatave, duke kërkuar të respektohet formalisht neni 568 i Kodit të Procedurës Civile, që në zbatim të nenit 567 të

Kodit të Procedurës Civile, identifikon dhe autorizon vetëm përmbauesin gjyqësor si subjekt që "bën shpalljen për shitjen e sendit në ankand".

Ndërkohë që, nga disa komunikime verifikuese, evidentohet fakti se, kërkesat për afishimin e shpalljeve të ankandeve dhe aktet e shpalljes së tyre drejtuar gjykatave, përmbajnë të njëjtin komunikimin postar të përcjellë nga adresa e subjektit ADCA, me logon dhe zarfet postare të këtij subjekti.

Nëse vërtetohet se për të gjitha shpalljet e ankandeve për shitje pronave të qytetarëve që përcillen pranë gjykatave në të gjithë vendin, janë realizuar dhe përfunduar ankande fiktive në mungesë të plotë të dijenisë dhe njoftimit të qytetarëve, atëherë do të gjendemi përpara fakteve të kryerjes së veprave penale nga një grup i strukturuar kriminal, çka do të duhet të angazhojë menjëherë, të

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shpalljet e Përmbauesve Gjyqësorë publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan www.gjykata.gov.al në rubrikën "Njoftime të tjera" me emërtimin "LAJMËRIM PËRMES AFISHIMIT".

Shprehim gadishmërinë tonë për të përcjellë tek ju kopje të kërkesave për afishim, që do të evidentohet nga ju si raste abuzive të shpallura me kërkesë të Zyrës Përmbauesit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

gjitha institucionet ligjzbatuese në vend për parandalimin dhe evidentimin e krimeve financiare, që mund të jenë kryer prej tij.

Në këto kushte, kërkohet bashkëpunimi dhe angazhimi juaj për të: evidentuar në mënyrë shteruese dhe përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare, kopje të akteve për "Shpallje të ankandit" për shitje të pasurive të paluajtshme, që pasqyrojnë kredencialet e të njëjtit përmbartues. Këto tre subjekte tregtare, në bashkëpunim me disa përmbartues gjyqësorë privatë, që u është hequr licenca nga ministri i Drejtësisë përgjatë viteve, 2017-2018 dhe 2022-2023 janë angazhuar në favor të implementimit të një skeme të mirëfilltë të mashtrimit me pasoja direkte për mijëra qytetarë e që dyshohet se kanë çuar në një nivel masiv public fenomenin e kallëzuar nga ministri i Drejtësisë, në shkurt 2020 - atë të "Shtrëngimit të debitorëve nëpërmjet procesit përmbartimor për marrjen e kredive të reja" në përfitim të institucioneve financiare jobanka, "M.C.A", "Final" dhe subjektit tregtar "ADCA".

Gjithashtu, lutemi që të përcillen bashkëlidhur jo vetëm kërkesat për afishimin e shpalljeve të ankandeve për procese përmbartimore që lidhen me këto dy subjekte, por pasi të verifikohet nga ana juaj, edhe

- kopje të zarfeve postare (si bashkëlidhur) me të cilat janë adresuar pranë secilës gjykatë këto kërkesa për afishimin e shpalljeve të ankandeve.

Ndihma dhe bashkëpunimi juaj për këtë proces është thelbësorë, për evidentimin e të gjitha fakteve që tregojnë për pëmasat reale të shtrirjes së një fenomeni që ka cenuar

rëndë dhe në numër tepër të lartë, qytetarët dhe familjet shqiptare dhe parandalimin e tij,

në mbrojtje të interesit të tyre.

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Gazetare Syri Tv M.H.

Më nevojitet një statistikë e numrit të divorceve të vitit 2023 dhe një krahasim me ato të vitit 2022.

Përgjigje 30

Bashkëlidhur përgjigje e kërkesës tuaj në lidhje me objektin e kërkesës "Padi për zgjidhje martese" (neni 125-163 i K.F) për vitin 2022-2023.

Në vijim të komunikimeve tona në lidhje me kërkesën tuaj ju informojmë se, nga rezultatet e regjistrave statistikore të cilët mund ti askesoni edhe në faqen zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al në rubrikën "Statistika", në lidhjen si në vijim <https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-rrethit-elbasan/statistika/c%C3%ABshtje-civile/>, rezulton se për vitin 2022 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë regjistruar 687 çështje të reja me objekt kërkesë "Padi për zgjidhje martese" (neni 125-163 i K. F) dhe kanë përfunduar 533 çështje.

Për vitin 2023, janë përpunuar të dhënat nga zyra e statistikave për periudhën janar-shtator 2023. Në këtë periudhë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, janë regjistruar 414 çështje të reja me objekt kërkesë "Padi për zgjidhje martese" (neni 125-163 i K. F) dhe kanë përfunduar 321 çështje.

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.H.

Jam duke mbledhur informacion mbi një raport që po realizoj në lidhje me temën *“Fshehja e te ardhurave”*, sanksionuar si veper penale në Kodin Penal, Neni 180

Bazuar në nenet 3 (pikat 1 dhe 3), 11 dhe 14 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, kërkoj prej jush të më vini në dispozicion në rrugë elektronike në adresën e e-mail mundësive disa vendime gjyqësore me objekt *“Fshehja e te ardhurave”* - Neni 180 si dhe Neni 180/a ndër vite (Mosdhënia e kuponit Tatimor) si dhe nëse ka patur vendime që ka patur për objekt të dyja këto vepra penale. Vendimet të jenë të viteve 2021-2022-2023 ose dhe më të hershme. Shpresoj që këto vendime të mund të më vihen në dispozicion në një kohë të shkurtër për shkak të kohës se limituar për leximin si dhe për përgatitjen e raportit për Shkollën e Magjistraturës.

Përgjigje 31

Bashkëlidhur ju dërgojmë hapat që duhet të ndiqni për të aksesuar vendimet gjyqësore. Suksese në punën tuaj.

Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se vendimet mund ti shkarkoni sipas bazës ligjore përtë cilën kryeni studime në faqen zyrtare të çdo gjykate duke ndjekur këto hapa:

Rasti ynë do të ilustruhet për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

1. Aksesoni në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al.
2. Vijojni përzgjedhjen me rubrikën **“Gjykatat shqiptare”**, përzgjidhni gjykatën për të cilën keni interes të zhvilloni studimin tuaj.
3. Në rastin tonë do të përzgjidhni rubrikën e fundit ku shfaqen **“Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm”** dhe më pas përzgjedhja vijon me **“Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”**.
4. Vijojni përzgjedhjen me rubrikën **“Çështje Gjyqësore”**, ku pas përzgjedhjes do t’iu shfaqendy nën rubrikat **“Çështje Civile”** dhe **“Çështje Penale”**.
5. Vijojni përzgjedhjen sipas interesit të tematikës së studimit me një nga rubrikat që shfaqen penale apo civile. Në rastin tonë kërkimi bazohet në nenin 180 të Kodit Penal, ndaj përzgjedhja do të jetë për **“Çështje Penale”**, pas klikimit të këtij opsioni do t’iu shfaqet tabela e kërkimit.
6. Për të listuar vendimet me bazë ligjore **“Fshehja e të Ardhurave”** neni **180 K.P.**, në tabelësi më sipër tek opsioni **“Lloji i çështjes”**, pas klikimit në të do t’iu shfaqen në listë të gjithë veprat penale sipas neneve përkatëse. Për lehtësi në kërkim klikoni gjithnjë germën e parë me të cilën nis baza ligjore në rastin tonë germën **“F”** dhe nëpërmjet scrollerit vijoni të shkoni deri në përcaktimin që jeni duke kërkuar. Në rastin tonë do t’iu shfaqet si në tabelën më poshtë përcaktimi **“FSHEHJA E TË ARDHURAVE (NENI 180 K.P)”**, ku pasi klikoni në opisonin **“Kërko”**

Pas përcaktimit ligjor për të kufizuar më mirë filtrat e kërkimit mund të vendosni tek osipioni **“Data e regjistrimit”** periudhën nga ku nis kërkimi studimor dhe tek **“Data e vendimit max”** datën e fundit ku përfundon kërkimi studimor.

Pas përcaktimit të filtrave të kërkimit, klikoni opsionin **“Kërko”** dhe do t’iu shfaqen vendimetsipas bazëz ligjore të kërkuar.
7. Në listën e shfaqur me vendimet sipas bazës ligjore dhe periudhës së përcaktuar në kërkim, klikoni opsionin **“Detaje”** dhe do t’iu shfaqet **“Informacioni mbi çështjen”**.
8. Për të shkarkuar vendimet elektronikisht në format të anonimizuar do të klikoni në opsionin **“Vendim Përfundimtar”** dhe tek opsioni informacion mbi çështjen, në fund të ikonës së pdf-së  sistemi do t’iu referojë

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkuar Gazetar A.B.

Gjatë vitit 2023, a ka pasur referime nga Prokuroria për veprën penale të sanksionuar në nenin 202/a të Kodit Penal “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër (Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019) Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.” Nëse po, në çfarë faze është gjykimi? Po gjatë viteve 2022, 2021, 2020, 2019 a ka pasur referime për këtë vepër penale, cili është fati i këtyre referime?

A janë dhënë dënime në 5 vitet e fundit për këtë vepër penale?

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkuar Gazetare B.K Top Channel

Kam nevojë për një info të lutem. Dua të di kur nis gjykimi i çështjes së poshtëshënuar.

Në funksion të njoftimit të publikut dhe medias komunikohet se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka përfunduar hetimet paraprake dhe ka dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr., viti 2023 në ngarkim të të Miturve në Konflikt me Ligjin : E.K.; S.M.; O.Ç., Xh.Ç

“Gjenero raport pdf”, nëse klikoni do të shkarkohet vendimi në formatin pdf.

Këto janë hapat për të aksesuar elektronikisht vendimet gjyqësore në faqet zyrtare të gjykatave të anonimizuar.

Nëse kjo formë kërkimi nuk ju vjen në ndihmë na kontaktoni.

Përgjigja e ilustruar edhe me foto nga sistemi.

Përgjigje 32

Bashkëlidhur gjendet përgjigje e kërkesës së depozituar nga ju më datë 07.12.2023.

Në cilësinë e kërkuar keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në postën elektronike manjola.kume@gjykata.gov.al, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën për dhënie informacioni, të regjistruar më datë 07/12/2023.

Pas shqyrtimit të kërkesës, ju informojmë se:

- 1- Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në regjistrin elektronik për vitin 2023, nuk rezultojnë regjistrime me objekt bazë ligjore Neni 202/a i Kodit Penal “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër “ .
- 2- Nga kontrolli ushtruar në regjistrat e statistikave të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për vitet 2018-2022, nuk rezultojnë regjistrime me objekt bazë ligjore Neni 202/a të Kodit Penal “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”.

Regjistrat e statistikave të çështjeve gjyqësore për vitet 2018-2022 janë informacion publik të cilët i gjeni të publikuar në faqen zyrtare të www.gjykataelbasan.gov.al .

Përgjigje 33

Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, seanca për të cilën shprehni interes do të zhvillohet më datë **07.12.2023 ora 09:30**.

Ju informojmë gjithashtu se për shkak të ndjeshmërisë së çështjes dhe për shkak të përfshirjes në ngjarje të shtetasve të cilët janë të mitur në konflikt me ligjin, në zbatim të Ligj Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, neni 21/2/4 përcakton: “2. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, të të miturit viktimë ose dëshmitar i një vepre penale. 4. Ndalohej identifikimi ose publikimi në çfarëdo formë i të dhënave personale të të miturit” dhe neni 89 të këtij ligji i cili përcakton se: “Gjykimi i një të mituri në konflikt me ligjin zhvillohet në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura”, seanca gjyqësore për këtë çështje në datë **07.12.2023 ora 09:30** do të zhvillohet **me dyer të mbyllura**.

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues G.S

1. Cili është numri i kërkesave për divorc kur bashkëshorti mban mbiemrin e bashkëshortes që prej vitit 2010?
2. Cili është numri i kërkesave për njohjen e atësisë biologjike kur bashkëshorti mban mbiemrin e bashkëshortes që prej vitit 2010?
3. Cili është numri i kërkesave për kundërshtimin e prezumimit ligjor të atësisë kur bashkëshorti mban mbiemrin e bashkëshortes prej vitit 2010?

Përgjigje 34

Kërkesat për informacion në postën elektronike shoqërohen me mjetin e identifikimit të kërkuesit dhe autorizimin e medias për të cilën kërkoni informacion.

Ju lutem kryeni procesin e identifikimit.

Ligj nr

Ju informojmë se LIGJ Nr. 119/2014 “Për Të Drejtën e Informimit”

Neni 11 përcakton:

Kërkesa për informim

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. 4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit; b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar. 5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Ju lutem kryeni procesin e identifikimit.

Nuk u identifikua

**Kjo kërkesë nuk është trajtuar gjithashtu pasi që nuk disponohen indekse manualë apo elektronikë në lidhje me këtë kategori pyetjesh.*

Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Ndiham Juridike Elbasan:

Informacion nëse (lista emërore për 62 shtetas), përfitues të ndihmës juridike dytësore:

1. Figuron një çështje gjyqësore e iniciuar prej tyre;
2. Cilat prej tyre kanë përfunduar me dhënien e një vendimi gjyqësor;
3. Në rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë presonat pjesë e listës janë në cilësinë e palës gjyqëhumbëse apo gjyqëfituese.

Përgjigje 35

Në cilësinë e kërkuesit, keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” shkresën me Nr. 32 Prot., të depozituar më datë 27.12.2023.

Ju informojmë se kërkesa është regjistruar me Nr. 2174/1 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 27.12.2023, dhe është depozituar për trajtim më datë 28.12.2023 në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun.

Pas shqyrtimit të kërkesës në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, dhe Neni 5/1/c të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit të Ndërmjet Ndiham Juridike Falas dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, Nr 823/1 më datë 24.05.2022, i cili parashikon: ***“Veprimtaritë e përbashkëta 1. Palët nëpërmjet strukturave të përcaktuara për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje dhe të përcaktuara në nenin 7, të saj, marrin përsipër të kryejnë bashkërisht: c) shkëmbimit të informacionit, me kërkesë paraprake, brenda fushës së kompetencave dhe në***

përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim kryerjen e analizave dhe studimeve sa i përket skemës së ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti”, ju informojmë se nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, realizuar sipas listës emërore të paraqitur në kërkesën Nr. 32 Prot., të depozituar më datë 27.12.2023 rezultojnë të dhënat, të cilat mund t'i përshtasni sipas nevojës tuaj për gjenerimin e tabelave statistikore, e renditura si më poshtë vijon:

1. **A. L.V**, ka paraqitur “Kërkesë për Dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore” për çështjen me objekt “Zgjidhje Martese”, të regjistruar me nr 9....., regjistruar më datë 11.01.2023, më datë 06.06.2023, Vendim Pranim Kërkese.
- **B.** Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nuk rezulton regjistrim kërkesë- padie me objekt “Zgjidhje Martese” me palë në proces shtetasin L.V
2. **A. A.S**, ka paraqitur “Kërkesë për Dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore” për çështjen me objekt “Zgjidhje Martese”, me nr 9....., regjistruar më datë 11.01.2023, më datë 19.01.2023, Vendim Pranim Kërkese.
- **B.** Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton regjistrim kërkesë-padie me objekt “Zgjidhje Martese” me nr 2....., regjistruar më datë 08.05.2023 me palë paditëse shtetasin A.S., me status në përpunim.
3. **A. S.K**, ka paraqitur “Kërkesë për Dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore” për çështjen me objekt “Zgjidhje martese. Caktimi i kujdestarisë për fëmijët e mitur”, me nr 9....., regjistruar më datë 17.01.2023, më datë 21.01.2023, Vendim Pranim Kërkese.
- **B.** Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nuk rezulton regjistrim kërkesë- padie me objekt “Zgjidhje Martese. . Caktimi i kujdestarisë për fëmijët e mitur” me palë në proces shtetasin S.K.
4. **A. A.B.** ka paraqitur “Kërkesë për Dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore” për çështjen (civile) për përjashtimin e tij nga detyrimi për pagimin e të gjitha tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore, në çështjen gjyqësore civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”, ku ai është palë paditëse, dhe palë e paditur është Sh.B, me nr 9....., regjistruar më datë 17.01.2023, më datë 17.05.2023, Vendim Pranim Kërkese.
- **B.** Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton regjistrim kërkesë-padie me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi” me nr 1....., regjistruar më datë 12.01.2023 me palë paditëse shtetasin A.B, me status në përpunim.

5. **A. I.O.**, ka paraqitur “Kërkesë për Dhënien e Ndhmës Juridike Dytësore” për çështjen me objekt “Zgjidhje Martese”, me nr 9....., regjistruar më datë 17.01.2023, më datë 02.10.2023 Vendim Pranim Kërkese.
- **B.**Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton regjistrim kërkesë-padie me objekt “Zgjidhje Martese” me nr 2....., regjistruar më datë 19.04.2023 me palë paditëse shtetasen I.O., me status në përpunim.
6. **A. I.T.**, ka paraqitur “Kërkesë për Dhënien e Ndhmës Juridike Dytësore” për çështjen me objekt “Zgjidhje e martesës dhe caktimi i kujdestarisë për fëmijët e mitur”, me nr çështje 9....., regjistruar më datë 23.01.2023, me datë 26.01.2023 Vendim Pranim Kërkese.
- **B.**Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton regjistrim kërkesë-padie me objekt “Zgjidhje e martesës dhe caktimi i kujdestarisë për fëmijët e mitur” me nr 2....., regjistruar më datë 15.03.2023 me palë paditëse shtetasen I.T., me status në përpunim.
